



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 9
04.06.2012

NR. VENDIMI 13
02.11.2012

V E N D I M

“PËR KONFISKIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e përbërë nga:

Gurali BRAHIMLLARI – KRYESUES
Iliriana OLLDASHI - ANETARE
Flora HAJREDINAJ - ANETARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Valbona ZENELAJ**, mori në shqyrtim, në Tiranë, në disa seanca gjyqësore publike, e fundit, sot në datë **02.11.2012**, ora 12.00, kërkesën me palë:

Kërkues/Paditës: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Përfaqësuar nga Prokurori B. M. .

KUNDËR : Të paditurit dhe Person në hetim **A. P.**, i biri i B. dhe i A. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në xxxx, xxxxxx-xxxx, në Rrugën: “ xxx xxxxx xxxx”, nr.xx, me shtetësi Italiane, gjykuar në mungesë, mbrojtur nga avokati i caktuar kryesisht, A. R. , Dhoma e Avokati së Tiranë.

OBJEKTI : **Konfiskimin e pasurisë** në pronësi të A. P. , Automjet tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të XXXX me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

Gjykata, pasi dëgjoji parashtrimin hyrës dhe kërkesat për prova të Prokurorit dhe të mbrojtjes, mori në shqyrtimi provat e kërkuara prej tyre, dëgjoji pretendimet përfundimtare të paleve në gjykim sipas të cilëve:

Përfaqësuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, Prokurori B. M. kërkoj:

I. Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

Konfiskimin e automjetit tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, në pronësi të shtetasit italian P. A. .

Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **znj. D. B. ,** e cila është administratore e Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Vlorë.

Avokati A. R. kërkoj: Rrëzimin e kërkesë për konfiskimin e kësaj pasurie e cila të mbetet nën sekuestro deri në përfundim të procesit penale në ngarkim të pronarit të kësaj pasurie A. P. .

Gjykata, si shqyrtoi pretendimet si më sipër të palëve, analizoi aktet e provat e paraqitura prej tyre dhe i vlerësoi këto dhe çështjen në tërësi:

V Ë R E N s e

Kërkesa e paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurisë objekt gjykimi duhet të pranohet pasi u gjend e mbështetur në prova edhe në ligj.

Nga shqyrtimi gjyqësor i akteve e provave të sjella nga palët në këtë gjykim, rezultoi e provuar sa vijon:

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në datë 29.10.2010, i ka përcjellë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë shkresën nr 3652, me Lëndë: Mbi ndalimin e shtetasit italian A. P. . Në këtë shkresë Prokuroria e Përgjithëshme ka bashkëngjitur edhe aktet e ardhura nga autoritetet italiane, mes të cilave edhe kërkesa për interpol Tiranën për arrestimin me qëllim ekstradimi në Itali të shtetasit A. P. .

Sipas këtyre akteve e provave shkresore të marra në shqyrtim edhe në këtë gjykim, provohet se ndaj shtetasit italian A. P. , Prokuroria e Leces-Itali, në datë 20/09/2010, kishte lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar, me Nr.3695/07 R.G.N.R 3087/08 GIP-71/10 OCC.

Rezulton se i dyshuari A. P. , ka qënë një person në kërkim nga drejtësia e shtetit Italian, pasi ai është akuzuar për kryerjen e veprave penale

të “Pjesëmarrjes në organizatë kriminale të tipit mafjoz”, ”Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe “Grabitje në rrethana rënduese” të parashikuara nga seksioni 416 BIS C I-II-III-IV-V, SEKSIONI 74 DPR 309/90, nenet 110, 629 CO1 dhe 2, nenet 628 CO2, nr.3 të Kodit Penal Italian.

Rezulton gjithashtu se nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, pasi ishin vënë në dijeni nga Interpopl Roma për vendndodhjen e të kërkuarit P. ishin bërë verifikime përkatëse si për vend banimin e tij edhe për hyrjet e daljet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga këto verifikime ka rezultuar se i dyshuari A. P. kishte kohë që ishte vendosur në qytetin e Vlorës, kishte çelur në këtë qytet disa aktivitete tregëtare duke marrë mjedise me qera për zhvillimin e aktiviteteve. Po kështu ai banonte në një apartament në qytetin e Vlorës, që kishte marrë me kontratë qeraja, në emër të bashkëshortes së tij, të quajtur A. G. R. .

Pikërisht në këtë banesë, në datën 29.09.2010, ora 04:00, është bërë i mundur edhe ekzekutimi urdhërit të arrestit ndërkombëtar dhe se pas kësaj, Prokuroria e Përgjithshme kërkonte nga Prokuroria e Rrethit Vlorë që të ndiqte procedurën për vleftësimin e këtij ndalimi dhe për ekstradimin e të kërkuarit Prudentino drejt shtetit të kërkuar, drejt Italisë.

Ndërkohë që ka ndjekur procedurën e orientuar nga organi qëndror i akuzës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka studiuar jo vetëm aktet e autoriteve Italiane, që ka marrë për ekzekutim të urdhër arresti ndërkombëtar të sipërcituar, por edhe ato që janë grumbulluar gjatë verifikimeve paraprake nga ana policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë Vlorë në lidhje me vendndodhjen dhe aktivitetin e zhvilluar nga i kërkuari P. në Vlorë.

Mbi bazën e katyre akteve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, provohet se, me datë 01.10 2010, **ka rregjistruar procedimin penal me numër 887, të vitit 2010, në emër të A. P. , për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal.**

Ndërsa me urdhërin e datës **05.10 2010**, provohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, **në këtë procedim penal ka rregjistruar edhe emrat e të dyshuarve E. Gj. dhe A. P. , si persona nen hetim, për të njëjtën veprë penale, pra për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal.**

Rezulton gjithashtu se, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me Vendim nr 244 datë 30.09.2010, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë duke miratuar arrestimin e shtetasit Italian A. P. , te kryer në datë 29.09.2010, si dhe ka miratuar sekuestrimin e provave materiale sipas procesverbaleve të sekuestrimit të datës 29.10.2010.**

Mbështetur në kompetencën lëndore që përcakton ligji 10 192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, provohet se, njëkohësisht, Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë Vlorë, me qëllim vijimin e procedurave për hetimin pasuror, ka dërguar aktet Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, dhe mbi këtë bazë rezulton se ky organ, në datë 01.10.2010, ka **regjistruar procedimin pasuror nr.20**, në ngarkim të të dyshuarit A. P. dhe ka vijuar hetimin pasuror kundër tij.

Në datën 05.10.2010, provohet se Prokuroria për Krime të Rënda ka vendosur të rregjistrojë në rregjistrin e procedimit pasuror nr 20 të vitit 2010 edhe emrat e të dyshuarve A. P. dhe E. Gj., si dhe të personave të lidhur me ta, V. K. , F. F. , G. P. dhe G. B. .

Gjithashtu, sipas kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike, që autoritetet italiane i kanë dërguar Prokurorisë së Përgjithshme Shqiptare, me Nr.10 Reg.Rog. N.3695/07, provohet se i padituri **A. P.**, ka lindur, në xx xxxx xxxx, në xxxxx (xx), dhe është banues në Rrugën: xxx xxxxx xxxxx nr.xx.

Në përmbajtje të akteve të ardhura nëpërmjet letërporosisë rezulton se A. P. **është hetuar** nga autoritetet e drejtësisë Italiane për veprat penale të cilësuar si “Bashkëpunim kriminal të tipit mafioz”, “Trafik droge”, “Grabitje në rrethana rënduese”, duke sqaruar se këto vepra penale parashikohen nga seksioni 416 BIS C. I-II-III-IV-V, seksioni 74 DPR 309/90, nenet 110, 629CD/1 dhe 2 dhe nenet 628 CO.3 Nr 3 të K.Penal Italian.

Sipas akteve të drejtësisë italiane, i dyshuari P. dyshohet se veprimtarinë e mësipërme kriminale e ka kryer në periudhën e viteve 2005-2007, në territorin e Republikës së Italisë.

Nga sa më sipër, Prokuroria Për Krime të Rënda, pretendon se i padituri **A. P.** , sipas nenit 3/1 pika «d», ligjit nr.10 192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, është subjekt i hetimit pasuror.

Për më tepër që ky persona është duke u hetuar edhe nga autoritetet shqiptare, respektivisht nga ana e Prokurorive e Rretheve Gjirokastrë Vlorë dhe Tiranë, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar si e tillë në nenin 287 të Kodit Penal Shqiptar. Për këtë veprë rezulton se hetimet janë zhvilluar edhe kundër shtetasit E. Gj. .

Mbi këtë bazë Prokuroria, bazuar në nenet 3/2 gerrat “a” “b” e ligjit nr.10192, datë 03/12/2009 ka kryer edhe veprime hetimore në lidhje me zbulimin, identifikimin, verifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiviteteve ekonomike të të paditurit **A. P.** , personave të tjerë, familjarëve apo dhe personave të lidhur me të,

Nga ky hetim pasuror ka rezultuar se të dyshuarit A. P. , A. P. dhe E. Gj. , si dhe personat e lidhur me ta, F. F. Xh. P. , V. K. , L. B. etj, zotëronin pasuri dhe

aktivitete, në qytete të ndryshme të Shqipërisë, më vetë apo në ortakëri me personat e tjerë të sipërcituar. Prokuroria për Krime të Rënda ka dërguar për gjykim sipas ligjit parandalues, kërkesën për sekuestrimin e konfiskimin e pasurive të gjëndura në emër të personave të lidhur me A. P. , pra, për pasuritë e aktivitet tregëtare në emër të A. P. , E. Gj. , si dhe personave te Tretë, V. K. , F. F. , G. P. dhe G. B. . Rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me Vendimin e saj nr.12, datë 07/10/2010, ka vendosur masën e sekuestros mbi pasuritë e shtetasve të sipërcituar, vendim i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit per Krime te Rënda Tiranë, me vendimin e saj nr.37, datë 25/11/2010.

Për këto pasuri provohet se, në datë 05.04.2011, Prokuroria për Krime të Rënda ka dërguar për gjykim kërkesën për konfiskim, gjykimi i cili është në vijim.

Por ndërkohë që çështja e sipërcituar ka qënë e është në gjykim, provohet se nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë kanë vijuar hetimet penale në lidhje me procedimin penal nr.1516, datë 01.10.2010 i regjistruar në ngarkim të shtetasit italian **A. P.** për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e provat shkresore të administruara e shqyrtuara në këtë gjykim, u provua se Policia Gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, gjatë kontrollit të automjeteve në vendin e quajtur “Shkolla e Marinës, në datën 25.11.2011 rreth orës 22.00, ndër të tjera ka bllokuar mjetin e tipit BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX që nga dokumentacioni që dispononte drejtuesi i mjetit, shtetasi P. P., rezultonte se ishte në pronësi të A. P. .

Më pas, nga dokumente e paraqitura ka rezultuar se ky automjet ishte përdorur e përdorej nga djali i personit që iu bllokua, nga A. P. P. , banorë i qytetit të Vlorës, por ndërkohë student në Tiranë, pasi ai kishte një akt përdorimi për këtë mjet nga pronari i tij që ka rezultuar se ishte pikërisht i dyshuari A. P. .

Në këto kushte për llogari të atij procedimi penal, Policia gjyqësore Pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë, në bazë të nbenneve 300-301 të K. Pr.Penbale, **me procesverbalin e datës 25 Nëntor 2011, ka vendosur të sekuestrojë** automjetin tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të zezë me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, së bashku me dokumentacionin përkatës duke përfshirë edhe dokumentin “Dëshmi aftësie për drejtim automjeti”, në emër të P. P. .

Ky procesverbal i mbajtur nga dy oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë ,është nënshkruar rregullisht edhe nga përdoruesi i mjetit P. P. .

Provohet gjithashtu se në datën 15.02. 2012, Policia gjyqësore pranë Prokurorisë Vlorë ka mbajtur procesverbalin “Mbi kthimin e dokumenteve të sekuestruara”, sipas të cilit rezultoi se shtetasit P. P. i është kthyer dokumenti “Dëshmi aftësie për drejtim automjeti, në të cilin është bërë shënimi:

“Dokumenti i sekuestruar nuk është më i nevojshëm të mbahet nga ana jonë. Pasi bërë dorëzimin e dokumentit, nga marrësi nuk u paraqitën pretendime”

Në këtë mënyrë, nga ana e Prokurorisë së Rrethit gjyqësor Vlorë, konfirmohet se sekestrimi mbi automjetin tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, nuk është revokuar, ai ka vijuar të jetë efektiv në kuadër të procedimit penal që ishte regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” sipas nenit 287 të K.Penal në ngarkim të të pandehurit A. P. .

Ndërsa në datën 22.05.2012, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, provohet se aktet e dokumentet e sekuestrimit të mjetit të sipërcituar si dhe dokumentacioni shoqërues i këtij mjeti, i janë dërguar Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, duke sqaruar se *dërgohen disa materiale shitesë që janë mbledhur në lidhje me procedimin penal nr.1516, në ngarkim të të dyshuarit A. P. për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.*

Prokuroria për Krime të Rënda, e cila kishte në proces verifikimi gjithë pasuritë e perosnit të dyshuar A. P. , pasi ka kryer edhe disa verifikime të posaçme për këtë çështje, ka sjellë kërkesën për gjykim, duke pretenduar se kjo pasuri i përket të dyshuarit A. P. dhe se ai e ka vënë atë me të ardhura të paligjësme, të përfituara nga aktivitetit kriminal për të cilën është kërkuar arrest ndërkombëtar, ka parashtruar kërkesën për konfiskimin e kësaj pasurie.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, Prokurori paraqiti për shqyrtim provat shkresore si vijon: Shkresa me nr.1231 kl/1 DKB 850, datë 09.09.2010 e Ministrisë së Brendshme; Shkresa me nr.1231 kl DKB 850, datë 28.09.2010 e Ministrisë së Brendshme, së bashku me aktet bashkangjitur; Procesverbal për ekzekutimin e urdhërit të arrestit datë 29.09.2010, së bashku me kontrollin personal të A. P. ; Raport shërbimi datë 29.09.2010 I Poilicisë Gjyqësore; Informacion nr.8759 prot, datë 30.09.2010 i Prokurorisë së Rrethit Vlorë; Shkresa nr.164/6 Prot, datë 27.10.2010, së bashku me kthimin e përgjigjes me nr.164/6 Prot, datë 17.11.2010, e InterForces. Me anen e ketyre akteve e provave shkresore qe Prokuroria pretendon se provohet që i padituri A. P. eshte subjekt i ligjit 10192 date 03.12.2009 sepse ai dyshohet se eshte pjesemarres ne veprimtarine kriminale te parashikuara nga neni 3 i ligjit 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ndërsa duke paraqitur provat e tjera në vijim si Shkresa me nr.5239 Prot, datë 22.05.2012 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me dokumentacionin bashkangjitur (relacionin e datës 21/05/2012), shkresën me nr.241/15 Prot, datë 01/12/2011, relacionin me nr.241/5, datë 01/12/2011, shkresa nr.50/9 Prot, informacioni i datës 26/11/2011, raporti i shërbimit i datës 25/11/2011, së bashku me dokumentacionin përkatës së mjetit objekt kërkesë për konfiskim, procesverbalin e sekuestrimit datë 25/11/2011, Prokurori pretendoi se në këtë gjykim provon faktin se në emer të të **paditurit A. P. gjendet vetem automjeti i tip BMË X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të XXXX me numër shasië XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.**

Gjykata pasi u shqyrtuan e debatuan provat shkresore në seancë gjyqësore të datës 02.07.2012, vendosi kryesisht, të thërrasë në cilësinë e dëshmitarit shtetasit A. P. me qëllim që të sqaronte rrethanat e marrjes në përdorim të mjetit dhe raportet e tij me të paditurin P. .

Nga dëshmia e tij rezulton se e ka pasur në përdorim këtë mjet pa patur ndonjë dokumentacion pronësie për të. Sipas dëshmisë së dëshmitarit A. del se ka filluar ta përdorë këtë mjet në fillim të viti shkollor pasi ai vazhdonte studimet në vitin e II-të, për arkitekture. Pra mjetin objekt konfiskimi e ka marrë në përdorim në muajin Nentor 2009, pa pasur as akt pronësie dhe asnjë dokumentacion tjetër për lejimin e përdorimit të tij. **Në mbrëmjen e datës 22 Shkurt 2010, rreth orës 12.30** e ka ndaluar Policia dhe i ka kërkuar dokumentat e makinës duke i bllokuar mjetin BMW.

Dëshmitari A. ka njoftuar të atin, P. P. dhe të nesërmen, në datë 23.02.2010, është takuar me pronarin e makinës A. P. , me të cilin kanë shkuar tek noterja M. Sh. . Aty kanë përpiluar e nënshkruar, sipas vullnëtit të tyre të shprehur para noteres **aktin e përdorimit të mjetit** objekt konfiskimi, I cili u shqyrtua në këtë gjykim dhe që është pjesë e fashikullit gjyqësor.

Dëshmitari A. dëshmoi se me këtë akt përdorimi ka lëvizur rregullisht në intenerarin Tiranë-Vlorë dhe anasjelltas dhe se nuk ka pasur problem me policinë. Mjetin sipas tij, Policia ia ka bllokuar babait të tij, P. P. , i cili nuk kishte akt përdorimi. Dëshmitari pretendoi se babai i tij, P. P. , në fakt e kishte blerë këtë mjet A. , por ai nuk dinte nëse kishin dokument shkresor.

Pas marrjes së dëshmisë së këtij dëshmitari, u thirr si dëshmitar edhe shtetasi **P. P. ,** i cili u pyet në seancën gjyqësore të datës 24.07.2012 dhe dëshmoi se:

“Ne vitin 2009, ne pushimet e gushtit, pasi kam patur dhe kam në administrim kompleksin “xxxxx” që ndodhet në Vlorë të “xxx x xxxxx”, kishte ardhur familjarish për pushime A. P. dhe aty jam njohur. Shprehi interes për të bashkëpunuar në punë në biznes, pasi kerkonte ambiente më qera në Vlorë, kaq më tha mua. Ketu lindi afrimiteti me te. I vume dy lokale në

dispozicion per te kryer aktivitetin e tij. Une e ndermjetesova por ishin prona qe une i kisha dhe i kam ne administrim. Mori me qera Xhelaterine dhe nje ambient tjeter qe e beri Kazino dhe ishim ne kontakt sepse ishin te pa perfunduara ambientet.”

Në lidhje me automjetin objekt konfiskimi, dëshmitari P. pretendoi se: **“Makinen une e kam blere ne Nentor te vitit 2009, me euro cash. Nuk e kam blere me kontrate me shkrim, por ne mirebesim pasi ai A. ishte ketu. Nuk vajtem te noteri pasi ne rastin qe do te beja kontratetn e shitblerjes duhet te behej ç’regjistrimi i makines ne Itali dhe une te beja pagesen e doganes ne Shqiperi.**

Meqenese ishte nentori i viti 2009 per te kursyer ndonje leke e shtyme si afat. Ndodhi qe ne Shkurt, ne kohen qe ia kisha lene djalit makinen pasi ishte student, e bllokoi policia nje nate ketu per mungese te aktit te perdorimit.

Mua me njoftoi djali per bllokimin e makines dhe A. P. u nis per ne Tirane dhe nepermjet telefonit ka kontaktuar me djalin tim Armalindo dhe pastaj ka vajtur te noteri per te bere aktin e perdorimit te mjetit.

Ne momentin qe u be akti i perdorimit nuk e shikoja te arsyeshme per te bere aktin e shitjes edhe per te mos paguar doganen pasi kushtonte ne vitin 2009 rreth 7 milion leke te vjetra.

Me dt.25.11.2011, pasi A. P. kishte nje vit e ca qe iku ne Itali, une e kam perdoror makinen qetesisht pasi rezulton se une kam marre edhe disa gjoba per levizjet me kete automjet, ne nje kontroll rutine te policise se takse forces ku une isha ne Rrugen “xxx x xxxxx” Vlore. Makina kishte nje mangesi qe kishte mbaruar afati i siguracionit te saj.

Njeri prej policeve, u kisha marre para per shezlonin dhe me sekuestruan makinen. Pas marrjes se automjetit nuk jam thirrur asnjehere, kam kerkuar te takohem dhe nuk kane pranuar duke me injoruar.”

Pyetjes se per te gjitha keto cfare thate a keni prova shkresore per te paraqitur para gjykates- dëshmitari P. iu përgjigj:

“Une personalisht nuk kam asnje dokument shkresor per te provuar blerjen e makines, por pervec deklarates se perdorimit te mjetit ne aktet e sekuestrimit te makines eshte siguracioni qe eshte prere ne emrin tim.”

Mbi bazën e provave të mësipërme, Prokuroria Për Krime të Rënda pretendon se automjeti , tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, është në pronësi të të dyshuarit A. P. , se ai nuk e ka tjetërsuar ndonjehere pronësinë e tij mbi këtë mjet, se nuk justifikoi vënioa e këtij mjeti prej tij.

Sipas Prokurorisë, bazuar në nenet 3, 5, 6, 8, 9 e vijues të Ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, i hetuari A. P. jo vetëm që është subjekt i zbatimit këtij ligji, por edhe se pasuria e gjetur në emrin e tij, duhet të konfiskohet sepse është rrjedhë e përfitimeve që ka pasur i dyshuari A. nga aktiviteti kriminal që ka zhvilluar në Itali dhe që ka vijuar edhe në Shqipëri në pastrimin e parave.

Mbrojtësi i caktuar kryesisht A. R. , pretendoi se nga ana e akuzes vetem u perdor termi “dyshim i arsyeshem” por nuk u arrit që ky dyshim të ishte i bazuar ne prova per veprimtari kriminale te shtetasit Italian A. P. te kryer ne shtetin Italian. Sipas mbrojtjes, Prokuroria pretendon se vetëm mbi bazen e nje urdheri arresti nderkombetar me anën e të cilit A. P. duhet te arrestohej, e për këtë atij duhet edhe t'i sekuestrohet dhe t'i konfiskohet pasuria objekt konfiskimi.

Mbrojtësi pretendon gjithashtu se nga ana e Prokurorise nuk u argumentua me fakte e prova se cila ka qene veprimtaria kriminale e ketij shtetasi ne territorin e Republikes se Shqipërisë, cili ishte perfundimi i procedimit penal me nr. 1516 date 01.10.2010, per vepren penale te “Pastrimit te produktit te vepres penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Pra, sipas mbrojtësit, Prokuroria pa dhene asnje prove, vetem duke u mbeshtetur ne supozime, kerkon qe te konfiskohet nje prone e cila nuk eshte vertetuar se eshte fituar ne menyre te paligjshme, prandaj kërkesa duhet të rrëzohet dhe automjeti të mbetet në masën e sekuestrimit të procedimit penal që po zhvillohet në Vlorë.

Gjykata, vlerëson se kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda është e drejtë, e mbështetur në prova e në ligj e duhet të pranohet.

Ndryshe nga sa pretendoi mbrojtësi, Gjykata çmon se në bazë të provave të marrë në shqyrtim në këtë gjykim, **i padituri A. P. ka qënë dhe është një person i dyshuar** si i përfshirë në një aktivitet kriminal që parashikohet si vepër penale, si nga legjislacioni i vendit të shtetësisë së tij, ashtu edhe nga legjislacioni penal i shtetit shqiptar.

Madje Gjykata konstaton se, në bazë të akteve të ardhura nga pala Italiane, veprimtaria e tij e dyshuar si kriminale është e cilësuar edhe për veprën penale të “Bashkëpunimit të tipit mafioz” dhe “Trafikimit të drogës”, përcaktime këto që përmbushin parashikimin e ligjit shqiptar për kryerjen e veprave penale në kuadër të krimit të organizuar dhe të “ Trafikimit të narkotikëve” sipas neneve 283/a e 333 e 334 të K.Penal.

Për këtë veprimtari kriminale ndaj të dyshuarit A. P. provohet se është lëshuar urdhëri i arrestit ndërkombëtar, i cili është vënë në ekzekutim nga autoritet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

Në këto rrethana, Gjykata ndryshe nga sa pretendoi mbrojtja, vlerëson se përmbushet plotësisht, koncepti i “dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në prova”, për pjesëmarrjen e të paditurit P. , në veprimtarinë e mësipërmne kriminale, pra në ‘Trafikimin e drogës’ dhe “Pjesëmrrje në krimin e organizuar të tipit mafioz” .

Për më tepër, Gjykata vlerëson se i padituri A. P. , është person nën hetim edhe në Shqipëri sepse edhe sipas organeve të drejtësisë shqiptare ai dyshohet se ka kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të

veprës penale” sipas nenit 287 të K.Penal dhe se hetimet për këtë vepër ende vijojnë.

Në këto kushte Gjykata, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, vlerëson se i **padituri A. P. është subjekt** i ligjit 10 192 datë 03.12. 2009 “*Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë*”, pasi dyshohet se ka konsumuar elementët e disa prej veprave penale të parashikuar nga neni 3 i këtij ligji.

Duke qënë subjekt i ligjit të sipërcituar, kërkesa e Prokurorisë për të vepruar, në përputhje me të edhe mbi pasuritë e të hetuarit A. P. është e ligjshme.

Ndonëse mbrojtja nuk e vuri në dyshim kriterin e përcaktuar në nenin 24 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009, që lidhet me të drejtat që ka i dyshuari mbi pasurinë objekt konfiskimi, **Gjykata**, duke analizuar e vlerësuar në tërësi provat e marra në shqyrtim, **bindet se pronar i mjetit tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, është i dyshuari A. P.** , se ai e ka blerë këtë pasuri rregullisht në datë **05.05.2009**, dhe se e ka rregjistruar atë në përputhje me legjislacionin e shtetit Italian, në regjistrin zyrtarë të automjeteve në datën 07.05.2009.

Nuk provohet se A. P. , këtë pasuri ta ketë tjetërsuar, ta ketë shitur apo dhuruar. Ai nuk ka hequr dorë nga tagrat e pronarit as kur ka qënë e nevojshme për tu paraqitur, para zyre noteriale në datën 23.02.2010, kur ka nënshkruar deklaratën për përdorimin e këtij mjeti, sipas përmbajtjes së të cilës ka thesuar : **“Jam pronar i automjetit”**.

Pra Gjykata bindet se automjeti , tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX është në pronësi të të dyshuarit A. P. dhe se ky mjet i është dhene vetëm në përdorim shtetasit A. P. me një deklaratë noteriale që provon e verteton vullnetin e pronarit që mjetin ta përdorë përdoruesi A. , por vetëm kaq.

Përveç të drejtës së përdorimit, i dyshuari A. P. nuk ka disponuar tagrat e pronarit mbi këtë mjet.

Kjo pasuri, në kohën e gjykimit ekziston, se ky mjet që nga momenti i sekuestrimit të tij më 25.11.2011 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, për llogari të procedimit penal **nr.1516, në ngarkim të të dyshuarit A. P. për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal**, procedim i cili po zhvillohet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata vlerëson se pasuria objekt gjykimi është krijuar nga i dyshuari P. , pas periudhës kur dyshohet se ai është përfshirë në aktivitetet kriminal për të cilat, siç u arsyetua më lart, ligji shqiptar 10 192, datë 03.12.2009, në nenin 3 të tij, parashikon veprimin parandalues mbi pasuritë e tij.

Gjykata, me qëllim sqarimin e rrethanave të marrjes në përdorim të këtij mjeti dhe verifikimit të pretendimeve në lidhje me pronësinë e tij, nisur nga fakti se në momentin e bllokimit të mjetit objekt konfiskimi, drejtuesit të mjetit i ishin bllokuar edhe dokumentet e tij, në të cilat gjëndeje edhe akti i përdorimit i datës 23.02. 2010, thirri në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit A. dhe P. P. .

Mbi bazën e provave që u morën në gjykim, Gjykata bindet se vullneti i pronarit A. P. , nuk ka qënë tjetërsimi i mjetit, por vetëm lënia e tij në përdorim.

Pretendimi i dëshmitarit P. P. se që të bëhej akti i shitjes duhej që më parë të bëhej ç’rregjistrimi në Itali dhe se kjo ka përbën pengesë për lidhjen e kontratës nuk qëndron e nuk mund të merret në konsideratë.

Nëse do të kishte vullnet pronari për tjetërsimin e mjetit, jo vetëm që ç’rregjistrimi mund ta kishte bërë sepse, në periudhën nga Nëntori i vitit 2009, (kur dëshmitari P. pretendon se e ka marrë në përdorim mjetin), e deri ditën arrestimit të pronarit të këtij mjeti më 29.10.2010, rezulton se, A. P. ka pasur hyrje e dalje të shumta nga e për në Itali, kështu që ai i ka pasur të gjitha mundësitë të bënte veprimet e nevojshme për tjetërsimin e mjetit, nëse do të dëshironte. Ai nuk e ka bërë ç’rregjistrimin sepse nuk e ka dëshiruar një gjë të tillë.

Edhe pretendimi tjetër i dëshmitarit P. se kontrata e shitblerjes me A. nuk është realizuar për shkak se blerësi duhet të pagunte vlerën e doganës, përsëri nuk mund të merret në konsideratë nga gjykata, sepse nuk është një justifikim i ligjëshëm.

Nuk rezultoi që dëshmitari P. P. të ketë bërë ndonjë kërkesë me shkrim për të kërkuar të drejta mbi sendin e seksuestruar nga Prokuroria e Rethit Vlorë dhe se edhe në këtë gjykim, ndonëse erdhi në dijeni të këtij gjykimi e objektit të tij, ai nuk paraqiti ndonjë kërkesë për të ndërhyrë si Person i Tretë as në këtë proces, megjithëse erdhi në dijeni e dëshmoi para gjykatës.

Edhe palët në gjykim nuk e pretenduan një gjë të tillë, ndërkohë që Gjykata, në mungesë të dokumentacionit shkresor për pretendimet e shtetasit P. P. , nuk e vlerësoi të nevojshme për procesin që të thirrej ai në cilësinë e Perosnit të Tretë.

Pra përfundimisht Gjykata vlerësoi se pronësia e të dyshuarit A. P. është plotësisht e provuar në gjykim dhe se ai asnjëherë nuk ka tjetërsuar tagrat e pronësisë tek persona të tjerë, por ka qënë gjithnjë pronar i mjetit tip BMVV X-5, me targa XX XXX X, me ngjyrë të xxxx me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se si i padituri A. P. , nuk disponojnë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë blerjen e kësaj pasurie, por kjo pasuri është krijuar si rezultat i veprimtarisë së paligjshme në fushën e “Trafikimit të narkotikëve” të kryer në kuadër të krimit të organizuar të kryer

prej tij në kuadër të organizatës kriminale “Sacra Corona Unita”.

Në këto rrethana Gjykata e gjeti të drejtë të mbështetur në prova e në ligj, kërkesën e akuzës për per konfiskim e pasurisë objekt gjykimi, pasuri e cila jashtë çdo dyshime, është ligjërisht në zotërim të të paditurit A. P. . Kjo pasuri është krijuar pas periudhes se perfshirjes të të paditurit në aktivitet kriminal, **se ajo nuk ka prejardhje të ligjshme e nuk u justifikua, prandaj Gjykata çmon se** përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 24 të ligjit parandalues për të urdhëruar që të konfiskohet.

Meqënëse kjo pasuri është sekuestruar në kuadër të procedimit penal që po zhvillohet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata vlerëson se në bazë të nenit 5 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, duhet të urdhërojë edhe pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së Konfiskimit të dhënë në kuadër të këtij ligji. Në bazë të dispozitës së sipërcituar “pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin ose eshuarjen e masës së sekuestrimit të dhëna me vendimin penal.

Pra efektivisht, masa e konfiskimit e dhënë nga kjo gjykatë, do të zbatohet, pas disponimit që do të behet në përfundim të procedimit penal nr 1516 i vitit 2010 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K.penal, procedim i cili zhvillohet edhe kundër të dyshuarit A. P.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 3, 5, 7, 21, 22, 24, 28-38 e vijues, të ligjit nr.10192 datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe në nenet 299/b, 302, 309 dhe 310 të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda duke urdhëruar **Konfiskimin e pasurisë automjet tip BMVV X-5, me targa XX XXX X**, me ngjyrë të zezë me numër shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, pronë e të dyshuarit A. P. .
- **Pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së konfiskimit** të këtij mjeti derisa të përfundojë dhënia e një vendimi gjyqësor penal për revokimin ose eshuarjen e masës së sekuestrimit të dhënë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 25.11.2011, për të njëjtën pasuri.
- Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **znj.D. B. ,** administratore e Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave –

Tiranë.

- Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Vlorë.
- Urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë kopjen e këtij vendimi Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tirane, Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Vlorë si dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit A. P. .
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall ne Tirane, me datë 02.11.2012 , ora 12.45.

SEKRETARE

Valbona ZENELAJ

GJYQTAR

Gurali BRAHIMLLARI

